



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA**

Nr. 832 prot.

Tiranë, më 20.05.2025

V e n d i m

Nr. 29, datë 20.05.2025

**Për vijim procedure për pranim për *anëtar i jashtëm* i Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 20.05.2025, referuar nenit 6 pika 3 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, nenit 10 pika 5 të Statutit; si dhe mbështetur në relacionin me nr. prot. 492/1 datë 09.05.2025 *Relacion teknik mbi verifikimin e dokumentacionit për kandidatin e propozuar për anëtar të jashtëm të Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë*, paraqitur Kryesisë prej komisionit teknik të verifikimit,

V e n d o s i:

1. Vazhdimin e procedurës për pranimin si *anëtar i jashtëm* i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për kandidatin David Kalaj (prof. dr.), propozuar në përputhje me Statutin;
2. Të kërkohet vlerësimi me shkrim për profilin shkencor-intelektual të kandidatit nga titullari i njësisë bazë ku punon kandidati dhe/ose departamenti përkatës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe të Matematikës, Universiteti i Malit të Zi, Podgoricë;
3. Në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 10 pika 3 të Statutit, si dhe të pikës 4.2 të *Aneksit nr. 2*, brenda muajit qershor kandidatura të shqyrtohet në komisionin e përhershëm të matematikës dhe Seksionin e Shkencave Natyrore e Teknike (SSHNT);
4. Votimi për kandidatin për *anëtar i jashtëm* i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë të bëhet në mbledhjen e radhës së Asamblesë;

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen sekretari shkencor dhe kryetari i SSHNT.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

